



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.05.2019, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

- 1.Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.05.2019.
- 2.Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Elena Xhina, Luan Duzha, Anduel Xhindi, Myslym Murrizi, Luan Harusha, Spartak Braho, Elona Hoxha, Edmond Rrushi, Paulin Sterkaj, Lefter Maliqi, Xhemal Qefalia, Arben Elezi dhe Ylli Shehu.

Mungojnë:

Alban Zeneli, Sadi Vorpsi dhe Antoneta Dhima.

I ftuar:

Adnor Shameti - anëtar i Komisionit të Ligjeve

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Faleminderit, për prezencën!

Përpara se ta deklaroj të hapur mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare dua t'ju uroj mirëseardhjen kolegëve më të rinj të këtij komisioni Arben Elezit dhe Elio Hyskës.

Mirë se erdhët! Punë të mbarë në komisionin tonë! Të gjithë kolegët do të jenë të gatshëm për çdo pyetje apo nevojë që do të keni, po ashtu edhe stafi që përbëhet nga një këshilltare Besmira Hysenbelliu dhe nga sekretarja Antonela Veshi.

Hapim mbledhjen e Komisionit tonë. Sot në rendin e ditës kemi njoftuar diskutimin nen për nen të propozimeve tashmë të bëra publike në Kodin Penal.

Relatore për këtë paketë ndryshimesh të propozuara në Kodin Penal jam unë, sikurse është njoftuar edhe në mbledhjen e parë, meqenëse sot kemi diskutimin nen për nen. pasi kemi votuar në parim. Nga propozuesit apo nga firmëtarët e paketës së ndryshimeve të propozuara kemi kolegun Adnor Shameti.

Përpara, në tryezë të gjithë kolegët kanë një material, një tabelë, që paraqet nenet mbi të cilat propozohen ndryshimet në Kodin Penal në krahun e majtë. Në krahun e djathtë është varianti i propozuar. Për lehtësi, meqenëse jo të gjithë kanë e Kodin Penal përpara do të doja të punonim me tabelën. Ndërkohë, unë do të bëj komentet si relatore për çdo nen. Kolegët nga të dyja krahët kanë të drejtë të na bëjnë pyetje, mua si relatore ose zotit Shameti si një ndër firmëtarët e projektit, por me shumë sinjeritet dua t'ju them se komentet janë mirëfilli profesionale. Diskutimin e parë politik e kemi ndarë që në momentin kur votuam për projektin, disa kolegë votuan kundër, shumica votoi pro tij, duke ua hapur rrugën në parim ndryshimeve në Kodin Penal.

Diskutimi nen për nen na ndihmon të gjithëve të përmirësojmë tekstin e propozuar të dispozitave, aty ku mendojmë se ka vend për të ndryshuar dhe për ta sjellë në gjuhën e duhur ligjore dhe në përputhje me gjuhën që Kodi Penal përdor në të gjithë pjesën tjetër të tij.

Fillojmë me nenin 1 të projektit. Ky nen propozon shtimin e një germe, konkretisht shtimin e një rrethane rënduese në nenin që parashikon rrethanat rënduese, neni 50 i Kodit Penal. Rrethana e propozuar është kur vepra është drejtuar ndaj personave të zgjedhur dhe funksionarëve publikë.

Për zotin Shameti dhe për kolegët do të thosha se nuk e gjej me vend këtë propozim për arsyen e thjeshtë që lidhet me formulimin e kësaj rrethane rënduese. Personat e zgjedhur ose funksionarët publikë mund dhe duhet të përfitojnë mbrojtje të veçantë nga ligji, sikurse është propozuar në nene të tjera vetëm për shkak të detyrës, jo për ndonjë arsye tjetër, për arsye të tjera ata duhet të trajtohen njëlloj si të gjithë shtetasit e tjerë apo njëlloj si të gjithë personat e tjerë. Formulimi ashtu siç është propozuar, të kryesh një vepër penale ndaj një funksionari shtetëror publik apo një të zgjedhuri dhe këtë ta përdorësh si një rrethanë për të rënduar dënimin ndaj atij që kryen një vepër nuk qëndron.

Së dyti, arsyeja tjetër është se ne për personat e zgjedhur dhe funksionarët publikë kemi propozuar rritjen e sanksionit penal, pra e kemi cilësuar veprën penale në rastin kur ajo ka për objekt të goditjes së saj të zgjedhurit ose funksionarët publikë. Një rrethanë nuk mund të jetë edhe rënduese, edhe cilësuese. Në momentin që bëhet cilësuese e ka të rritur ndëshkimin, ndërsa kur mbetet rënduese gjykata ka për detyrë që ta aplikojë dhe të rrisë dënimin.

Do të ftoja edhe kolegun Shameti për një opinion, por edhe kolegët e tjerë përpara se të votojmë. Mendim im si relatore është që kjo rrethanë rënduese nuk mund të qëndrojë si e tillë.

Adnor Shameti - Faleminderit, zonja kryetare!

Në variantin që kemi paraqitur, një ndërhyrje te pjesa e përgjithshme e Kodit Penal që ka të bëjë me shtimin e një rrethane rënduese te neni 50, unë e shikoj krejt me vend variantin origjinal të paraqitur nga grupi propozues, për arsye se analogjia është e njëjtë edhe me germën “f” të nenit 50 ekzistues të Kodit Penal, ku bëhet fjalë për përfaqësuesit e shteteve të tjera që janë sërish subjekte të posaçme. Në këtë kuptim, ky grup subjektësh të posaçme, që funksionari publik apo funksionari i larë shtetëror të jetë pjesë e inkorporuar e nenit 50 është gjëja më normale dhe gjëja më e natyrshme. Gjithsesi ne jemi të hapur që sugjerimet dhe vërejtjet tuaja t'i shqyrtojmë me përgjegjësi në Komisionin e Ligjeve si komisioni përgjegjës duke marrë të gjithë vëmendjen e duhur nga ana jonë.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët e tjerë?

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina - Faleminderit, zonja kryetare!

Realisht, lidhur me nenin 50 të ndryshimeve në projektligj edhe unë kam rezervat e mia, pasi do të qëndroja në të njëjtën linjë mendimi, që ju sapo parashtruat. Nuk kemi pse

personave të zgjedhur dhe funksionarëve publikë t'u japim një mbrojtje të veçantë në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal, kur në pjesën e posaçme kemi parashikuar ndryshimet që parashikojnë deri dënimet e tyre. Megjithatë mendoj se kjo duhet të shikohet në përgjithësi me frymën që kërkon të përçojë Kodi Penal me ndryshimet e reja. Nëse do të mendonim se duhej të fusnin personat e zgjedhur apo funksionarët publikë, atëherë lind pyetja: pse të mos fusim mjekët, apo ndonjë kategori tjetër? Pra, edhe unë jam me shumë rezerva për nenin 50 dhe mendoj se ky propozim duhet t'i kalojë Komisionit të Ligjeve si komision përgjegjës për ta shqyrtuar me shumë përparësi këtë dispozitë.

Ermonela Felaj - A ka ndonjë opinion tjetër nga kolegët? Ideja është se në rast se goditet për detyrën një funksionar ose një i zgjedhur, ai të marrë mbrojtje të veçantë duke u dënuar më shumë autori, por nëse ndaj tij ndodh një tjetër vepër penale, për shembull plagoset apo rrihet apo hyn në një konflikt tjetër penal, ai nuk ka pse të marrë mbrojtje të veçantë për cilësinë që ka. Mbrojtjen duhet ta marrë për shkak të detyrës, pra kur vepra që ndodh ndaj tij i ndodh për shkak të detyrës. Ne mund ta përdorim këtë si rrethanë rënduese, por jo e thënë "kur vepra kryhet ndaj tij si person" dhe ta rëndojmë dënimin për shkak se ka cilësinë e të zgjedhurit ose të funksionarit publik. Nëse vepra lidhet me motive të zbatimit të detyrës nga ana e funksionarit publik apo e të zgjedhurit, atëherë kjo mund të vlejë, por ne e kemi bërë ndërkohë këtë propozim, sepse kemi ndërhyrë te goditja për shkak të detyrës dhe e kemi cilësuar konkretisht. Prandaj më duket e pavend që të ndërhyhet në nenin 50. Jam e mendimit që ose të lihet siç është ose formulimi të rishikohet, se ashtu siç është shkruar, nuk qëndron. Nuk ka pse për vepra të tjera këta të kenë mbrojtje të veçantë, nuk ka asnjë arsye, sepse njerëzit janë të barabartë para ligjit. Mbrojtjen do ta merrte vetëm për shkak të detyrës që ushtron.

Po, zoti Sterkaj.

Paulin Sterkaj - Unë jam dakord me kryetaren, zonjën Felaj. Nëse Kodi Penal parashikon për të gjithë njëlloj, nuk ka pse të marrë mbrojtje të veçantë apo të rritet dënimi i atij, sepse i ka rënë një të zgjedhuri ose ka dëmtuar një të zgjedhur. Kodi Penal e parashikon. Në Kodin Penal ka mjaftueshëm organe kompetente ligjzbatuese që t'i ndjekin problemet siç duhet për të realizuar atë mbrojtje që u duhet individëve të zgjedhur dhe njerëzve të thjeshtë. Pra, për mua është i mjaftueshëm.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Sterkaj!

Nëse nuk ka opinione të tjera, kush është dakord me këto vërejtje t'ia propozojmë Komisionit të Ligjeve? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1 me vërejtjet e propozuara.

Neni 2, i cili bën fjalë për neglizhencën në trajtimin mjekësor. Është një ndër nenet që ka ngjallur më shumë debat në publik edhe për faktin se në raste të ndryshme të humbjes së jetëve njerëzore nëpër ambiente spitalore ose jo, por gjithsesi kanë pasur një kontakt me mjekun, subjekt shpeshherë janë bërë mjekët dhe ngaqë ka pasur një reagim të rënduar ndaj tyre, në kuptimin që është marrë masa ekstreme, janë arrestuar, kjo ka shkaktuar edhe debate.

Më duhet të jap opinionin tim në lidhje me këtë nen.

Së pari, nuk bën sens, sepse neglizhenca është pakujdesi në vetvete dhe kjo është një ndër format e fajit. Faji është elementi i veprës penale, nëse nuk ka faj në kryerjen e një veprimi nuk mund të ketë vepër penale.

Ndërkohë faji vetë ndahet në dy forma të mëdha: në dashje dhe në pakujdesi. Këto dy forma të mëdha, kanë nënforma. Dashja: dashje direkte, indirekte. Pakujdesia: neglizhenca dhe vetëbesimi i tepruar. Janë të parashikuara në Kod, të pjesa e përgjithshme, janë të dhëna në Kod se çfarë kupton njëra dhe tjetra. Neglizhenca është rasti kur t'i i njëh pasojat, nuk i dëshiron, por nuk merr masa që t'i ndalosh ato. Vetëbesimi i tepruar është kur ti i njëh pasojat i parashikon, por mendon se mund t'i evitosh ato.

Diskutimi është pak teorik dhe me propozimin e ardhur synojmë, ashtu siç është shkruar që neglizhenca në trajtimin mjekësor të dënohet, kur ti je i aftë profesionalisht, por nuk i kryen veprimet, të gjitha ato që duheshin bërë. Ndërsa vetëbesimi nuk dënohet sipas propozimit. Që këtu nuk përbën sens, sepse duke qenë një formë e fajit, faji në vetvete, do të thotë se faji duhet të ndëshkohet, pa faj nuk dënohet njeri. Problemi i parë që kam është te përdorimi i shprehjes “neglizhenca”.

Problemi i dytë është përdorimi i termit “profesionisti shëndetësor”. Unë nuk e di nëse ndonjë ligj, që ka të bëjë me shëndetësinë edhe për shkak të *background*-it që ka ky komision, të ketë ndonjë përkufizim për këtë term. Nëse ka një përkufizim për termin “profesionist shëndetësor”, jam dakord që ky term të qëndrojë edhe në përmbajtjen e dispozitës, por nëse nuk ka, atëherë nuk ka pse të përdorim terma me natyrë të përgjithshme, sepse si juristë e dimë, që këto gjithmonë përbëjnë shkak në praktikë për debat nëse është apo jo profesionist shëndetësor. Duke i qëndruar kësaj ideje, ne mund t'i qëndrojmë formulimit aktual të dispozitës, ku thuhet: “Mjeku ose personeli tjetër mjekësor”, sepse nuk ka qenë ky term problemi. Në zbatimin e kësaj dispozite nuk ka qenë ndonjëherë

problem identifikimi i subjektit. Ky i fundit ka qenë i qartë për zbatuesit e ligjit në praktikë.

Vërejtja e tretë është që minimumi i dënimit, në paragrafin e dytë nuk mund të jetë si në paragrafin e parë, sepse në paragrafin e parë flasim për një rrezikim të jetës ose për një plagosje të rëndë të personit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet. Në paragrafin e dytë flasim për një pasojë më të rëndë, flasim për vdekjen e personit dhe përsëri...

Jo, ju kërkoj ndjesë, tërhiqem, sepse është më e lartë. Mendova sikur ishte gjobë dhe ishte e njëjta gjë.

Që ta përmbyll komentin tim, nuk e di nëse duke e formuluar në këtë mënyrë nenin 96 “Neglizhenca në trajtimin mjekësor” e kemi zgjidhur problemin e mjekëve, sepse problemi, në gjykimin tim, ka lindur nga zbatimi i dispozitës dhe jo nga dispozita në vetvete. Gjyqtarët dhe prokurorët shpeshherë u referohen akteve të ekspertimit që bëjnë mjekët ligjorë. Në vetvete janë përsëri kategoria e mjekëve ata që përcaktojnë për veten e tyre nëse një shkelje që mjekët kanë bërë gjatë punës ka ardhur nga pakujdesia, nga neglizhenca apo nga vetëbesimi i tepruar që kanë. Do të gjykoja t’u jepnim më tepër vend opinionëve që do të merren në Komisionin për Shëndetësinë për këtë nen, sepse nga pikëpamja formale ose juridike, ka disa momente, ku ashtu siç është ndërtuar është e vështirë të qëndrojmë apo të zgjidhë problemin. Megjithatë ne mund ta hapim diskutimin për atë sa mundemi në këtë komision dhe pastaj t’ia referojmë Komisionit të Ligjeve.

Adnor Shameti - Faleminderit, zonja kryetare!

Pa dashur të bie në përsëritje në analizën e figurës së veprës penale që zonja Felaj bëri, e gjej me vend të sqaroj shkurt identifikimin e elementeve të figurës së veprës penale. Është krejt normale që në nenin 2, që kemi paraqitur në variantin e propozuar para Komisionit të Sigurisë, të flitet për neglizhencë. Nëse do të flitej për formë tjetër faji, pasi është “dashja” dhe “pakujdesia” që në këtë rast është vetëm në formën e “neglizhencës” dhe jo të “vetëbesimit të tepruar” që është për një grup tjetër veprash penale, më së shumti është te shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, formë kjo e pakujdesisë, e vetëbesimit të tepruar, në këtë rast e shikojmë vetëm të shprehur në formën e neglizhencës, sepse po të kishim “me dashje” nuk do të ishte kjo vepër penale, por do të ishte “plagosje me dashje” apo diçka tjetër. Forma e fajit, e cilësuar në variantin që kemi paraqitur bën edhe identifikimin e veprës në vetvete, pasi flasim për një subjekt të posaçëm, që është mjeku apo

personeli ndihmës, i cili në kryerjen e veprimtarisë rutinë në profesionin e vet mund të sjellë pasoja të cilat janë përherë në formën e fajit, parashikuar në formën e neglizhencës.

Cilësimi në përshkrimin e kësaj dispozite, të kësaj figure vepre penale, të formës së fajit shprehimisht bën dallimin me veprat e tjera. Kështu që ne si propozues i qëndrojmë variantit që të jetë e tillë, e identifikuar si neglizhencë. E para.

E dyta, jam dakord me kryetaren që, kur ta shqyrtojmë në Komisionin e Ligjeve, t'i bashkëngjiten vërejtjet lidhur me identifikimin mot-a-mot të subjektit të posaçëm që është në këtë rast. Pra, sa i takon identifikimit të saktë të subjektit apo grupit të subjekteve që do të jenë pjesë e kësaj dispozite, ta shikojmë në përputhje me legjislacionin përkatës dhe kur ta kalojmë edhe në Komisionin e Ligjeve për teknikë legjislative të bëjmë edhe rregullimet përkatëse që të mos ketë konfuzion.

Ermonela Felaj – Ju mendoni se do të jetë kaq e thjeshtë në praktikë, që një mjek ligjor të ndajë kur një tjetër mjek ka vepruar me neglizhencë apo kur ka vepruar me vetëbesim të tepruar?

Më duket shumë subjektive se si do ta ndajmë formën e fajit, ndërkohë që faji në vetvete, pakujdesi apo jo, neglizhencë apo jo, vetëbesim i tepruar apo jo, është i dënueshëm.

Ne kemi përjashtuar një nga format dhe kemi thënë se është e padënueshme.

E kam me qëndrimin në përgjithësi. A mos duhet të mbajmë një qëndrim, ose ta dekriminalizojmë tërësisht këtë, ose ta definalizojmë tërësisht këtë gjë dhe ta lëmë si një shkelje mjekësore që le të dënohet nga kodet mjekësore, apo domosdoshmërisht ne duhet të kemi një diskutim të Kodit Penal? Mendoj se është momenti që ne ta shprehim këtë opinion.

Adnor Shameti – Për mendimin tonë ky grup, subjekti i posaçëm, për sigurimin e marrëdhënieve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve është e detyrueshme që opinionin publik të ketë garanci shtesë që, kur të shkojë për trajtim në një institucion mjekësor të parandalojë ardhjen e pasojave të dëmshme, prandaj ne si grup propozues mendojmë se është shumë e rëndësishme kjo dispozitë që të dekriminalizohet në këtë formë që është paraqitur.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

A ka ndërhyrje të tjera?

Urdhëroni, zoti Sterkaj!

Paulin Sterkaj – Dua t'ju bëj një pyetje juve, që jeni iniciatorë të këtij amendamenti.

A keni shfletuar praktika ndërkombëtare të këtyre fenomeneve? Nga e nxirrini ju këtë konkluzion? A është përshtatur për territorin shqiptar apo duhet të marrim një eksperiencë të avancuar ndërkombëtare? Çfarë parashikohet për viktimat, për ata që kanë pasur pasoja si rezultat i neglizhencës apo i fajit të mjekëve?

Adnor Shameti - Faleminderit!

Ju siguroj që grupi i punës është njohur, pasi kemi qenë në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Drejtësisë, edhe me ministrinë e linjës, si dhe me zyrën e EURALIUS-it atashuar pranë Kuvendit të Shqipërisë. Pra, ju sigurojmë se përcjellim praktikën më të mirë të vendeve perëndimore.

Sa i takon parashikimit dhe kriminalizimit të kësaj dispozite, jam dakord me ju që nuk kthehet pas pasojave, por qëllimi i kësaj dispozite është shmangia e ardhjes së pasojave, parandalimi i pasojave për shkak të keqtrajtimit gjatë asistencës mjekësore. Ky është qëllimi në vetvete i dispozitës, në të kundërt nuk do të kishte asnjë lloj mbrojtjeje.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Me sa kuptoj nga qëndrimet, ideja është që të ketë një nen në Kodin Penal, i cili e dënon neglizhencën nga ana e trupës mjekësore, sepse veprimet e pakujdesshme të tyre mund të çojnë në uljen e jetëve njerëzore. Por mendoj se duhet të ketë një reflektim se për cilën pjesë të fajit duhet të mbahet ky qëndrim kriminalizues.

Kalojmë në votimin e nenit 2.

Kush është dakord me vërejtjet për nenin 2?

Faleminderit!

Neni 2 i propozohet së bashku me vërejtjet e Komisionit të Ligjeve.

Neni 3 parashikon shtimin e një neni të ri në Kodin Penal me titull “Shkelja e të drejtave të autorit”. Për propozuesin do të thosha që kjo dispozitë e re shtohet në seksionin “Mashttrimet”, por në fakt po të lexosh këtë dispozitë të propozuar dhe një tjetër dispozitë që e ka Kodi Penal, ndërkohë, i cili titullohet “Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit” do të vërenim se trajtojnë të njëjtën gjë.

Unë mund t’ua lexoj kolegëve për të qenë të hapur me njëri-tjetrin. Ky nuk është një nga ato nene, që është zbatuar shumë në praktikë dhe ndoshta kjo është edhe arsyeja që tingëllon si një gjë e re propozimi me një titull të ndryshëm “Shkelja e të drejtave të autorit”, por ndërkohë në Kodin Penal që nga viti 2001 ne kemi një vepër penale që titullohet “Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit”, ku thuhet: “Riprodhimi tërësisht ose pjesërisht i veprës letrare, muzikore, artistike ose shkencore, që i përket një tjetri, ose përdorimi i tyre pa

pëlqimin e autorit, ku ka shkelur vetjake dhe pasurore të tij, përbën kundërvajtje dhe dënohet në masën që parashikon ligji”.

Neni 149/c që propozohet thotë: “Shpërndarja, komunikimi në publik, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, ekspertimi ose importimi për qëllime të tërthorta apo të drejtpërdrejta, përfitimi i veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit pa pëlqimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës përbën kundërvajtje penale”.

Në gjykimin tim kjo dispozitë e propozuar përplaslet me dispozitën aktuale, sepse çdonjëra nga këto forma që thotë kjo dispozitë, në vetvete përdorim është. Pra, ti përdor veprën e tjetrit që mund të jetë vepër letrare, mund të jetë vepër shkencore, mund të jetë një këngë, një kompozim e të tjera pa lejen e autorit, ose i riprodhon tërësisht nën emrin tënd, ndërkohë që e ka bërë një tjetër, ose i përdor në një nga këto mënyrat që propozohen që do të thotë se ne përdorimin edhe tani e kemi të penalizuar.

Pra, unë do të isha që, meqenëse të drejtat e llojeve të tjera, pronësi industriale dhe tipografike, janë të mbrojtura në mënyrë të veçantë, pra ngelet që vetë të drejtën për këtë vepra që thamë, kulturore, artistike, shkencore të mund të mbrohen, do të isha e mendimit që nenin 149 ne ta rishikojmë në përmbajtje, t’ia ndryshojmë titullin, mos t’i vëmë titullin “Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit”, sepse duket sikur është rasti kur ti e merr dhe e boton veprën e tjetrit nga fillimi në fund me emrin tënd, por t’ia vëmë titullin “Shkelje e të drejtave të autorit”, ta riformulojmë pa qenë nevojë që të bëjmë një nen tjetër të ri.

Urdhëroni, zoti Shameti!

Adnor Shameti - Faleminderit!

Jam shumë i qartë dhe ndaj të njëjtin qëndrim me ju në atë që realisht varianti i propozuar i paragrafit të parë të nenit 3, që ne kemi propozuar për ndërhyrje në nenin 149 dhe shtimin si një paragraf më vete apo si një dispozitë më vete, e shoh me vend që mund të inkorporohet, megjithëse formulimi që kemi bërë ne është shumë i gjerë dhe parashikon gjëra më të mëdha, e shikoj me vend që sa i takon paragrafit të parë mund ta inkorporojmë dhe ta bëjmë të zgjeruar, duke ndryshuar venin 149 ekzistues të Kodit Penal.

Sa i takon paragrafit të dytë, që është i cilësuar të qëndrojë si i tillë duke bërë një dispozitë më vete, sugjeroj që edhe Komisionit të Ligjeve t’i paraqesim të tillë si propozim, edhe për teknikë legjislative, që të mos kemi përsëritje të varianti ekzistues i nenit 149 me paragrafin 1 të nenit 3 që ne parashikojmë t’i integrojmë me njeri-tjetrin të dy, të bëjmë variantin më gjithëpërfshirës dhe paragrafi 2 i nenit 3 të rrijë kështu siç është.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – A ka komente të tjera nga kolegët?

Besoj se jemi dakord që dispozita e propozuar të reflektohet në nenin 149 aktual të Kodit Penal, siç u diskutua në komision.

Faleminderit!

Miratohet edhe ky nen me këtë modifikim.

Kalojmë në nenin 4.

Ky nen parashikon ndërhyrjen në nenin 197 të Kodit, që bën fjalë për organizimin e lotarive të palejuara. Pra, organizimi i lotarive, i lojërave të fatit apo bixhozit janë të dënueshme aktualisht me gjobë apo burgim deri në 3 muaj.

Në këtë nen, edhe për shkak të ndalimit të plotë të të gjithë lojërave të fatit dhe të pikave ku ato organizoheshin jemi munduar të reflektojmë dhe është propozuar një ndryshim për të cilin unë kam disa komente, ndonëse në parim jam dakord.

Besoj se dispozita duhet shkruar pak më mirë duke ndarë paragrafët nga njëri-tjetri dhe dënimi duhet të përshkallëzohet. Në qoftë se në paragrafin e dytë, e tretë apo e katërt flasim për një rrethanë të rënduar, edhe dënimi duhet të vijë, përgjithësisht, si mekanizëm, duke u rënduar, jo duke u zbutur.

E dyta, është thënë këtu “organizmi dhe ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit”. Unë kam dy opinione në këtë pikë. Mendoj ta heqim fjalën “i veprimtarive”, sepse lojërat e fatit nuk mund të konsiderohen veprimtari dhe të themi: “Organizmi dhe ushtrimi i lojërave të fatit, lotarive apo bixhozit dënohet”. Pika e parë.

Pika e dytë. Ne kemi thënë se në paragrafin e dytë është propozuar që në rast se këto lojëra bëhen me të mitur nën 18 vjeç, të dënohen më rëndë. Dakord, por duhej shprehur më drejt dispozita.

Pra, ideja është se ne do të dënojmë organizatorët e lojërave me të mitur, nuk do të dënojmë të miturit që marrin pjesë në lojëra, se ky është qëllimi, prandaj duhet ta shprehim më drejt.

Nuk do të isha për përkormin e shprehjes “fëmijë nën 18 vjeç”, sepse Kodi në çdo nen të tij përdor shprehjen “me të mitur” dhe e ka të përkufizuar se çfarë nënkupton me “të mitur”.

Në paragrafin e fundit thuhet: “Pjesëmarrja në lojërat e fatit dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit”. Ky paragraf me paragrafin e parë mua më krijon pak problem, sepse në paragrafin e parë thuhet: “organizmi dhe ushtrimi”, pra ushtrimi i lojërave të fatit dënohet. Po të ushtrosh lojëra fati do të thotë të marrësh pjesë, vetëm në qoftë se ideja ka

qenë organizmi dhe ushtrimi si veprimtari i lojërave të fatit, se në fat ato si veprimtari ekonomike janë ushtruar.

Atëherë, ne mund t'i mbajmë me këto korrigjime edhe paragrafin e parë, edhe paragrafin e katërt. Po e përmbledh, pra do të ishte mirë që në paragrafin e parë do të ishte mirë të thuhej: “organizmi dhe ushtrimi si veprimtari i lojërave të fatit, lotarive apo bixhozit dënohet me burgim nga 1-3 vjet”.

Në paragrafin e dytë mendoj të thuhet: “organizmi i kësaj vepre me të mitur dënohet” aq sa është propozuar. Pjesëmarrja në lojërat e fatit nga cilido, të mitur apo madhor, të jetë e dënuar.

Pra, mendoj se kështu duhet të formulohet kjo dispozitë në total.

Urdhëroni, zoti Braho!

Spartak Braho – Dakord jam me logjikën tuaj.

E para, ne duhet të shtojmë masat e dënimit me gjobë.

E dyta, dënimin me gjobë e kemi lënë blanketë, nuk kemi e kemi parashikuar se sa është kjo gjobë, deri ku varion kjo gjobë. Madje po ta shohësh me kujdes, të tëra propozimet, që parashikojnë dënimin me gjobë, nuk kanë masën e gjobës.

Pra, duhet të jemi të kujdesshëm, se në qoftë se do të biem dakord ne duhet të caktojmë masën e gjobës, se pastaj ia fut gjykata si t'ia dojë qejfi.

Ermonela Felaj – Në dispozitën e propozuar nuk ka asnjë paragraf ku është parashikuar dënimi me gjobë. Vetëm tek e fundit kemi “me gjobë ose me burgim” por është minimumi i gjobës.

Paulin Sterkaj – Kam një sugjerim. E shoh se ne e kemi qejf burgun dhe jemi duke ndërtuar burgje përditë në Shqipëri. Si duket, institucioni i burgut është hapur si vend i ri punësimi.

Pse nuk parashikohen në çdo nen dënimet alternative, apo vetëm burgu qenka praktikë këtu në Shqipëri? Edhe jemi shtet i pasur shumë ne, kemi mundësi t'i mbajmë në burgje të dënuarit me paratë e taksapaguesve shqiptarë! Pse të mos kemi mundësi për dënime alternative, siç e tha zoti Spartak, me gjobë, por ka edhe dënime të tjera, si për shembull me punë sociale. Njeriu nuk riparohet vetëm në burg, riparohet edhe me masa të tjera penale.

Pse duhet të jemi kaq të ashpër në Kodin Penal? Kemi mundësi të gjejmë dënime alternative, të cilat përfshihen në praktikën europiane. Ne edhe duam të hyjmë në Europë, edhe duam të kthehemi nga Afrika: t'i presim dorën atij që vjedh. A kemi mundësi të

përdorim edhe dënime alternative apo jo? Nuk e kuptoj: e mendoni atë çfarë po bëni apo s'e mendoni?

Nuk është vetëm dënimi me burg ai që rregullon çdo gjë në këtë botë. Njeriu bie në gabim edhe pa dashje, edhe i nxitur nga një emocion, edhe nga një gjendje jo e mirë shpirtërore. Shkon e luan bixhoz. Pse, duhet të shkojë në burg ai? Nuk është e mundur të ketë një dënim alternativ?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj, këtë kërkesë kam. Unë e di se sa më shumë që ligji shtrëngohet, aq më pak dënime ka, por të paktën të kenë edhe dënime alternative, që t'i japim mundësi gjithkujt për ta kuptuar se nuk duhet të bëjë gabime. Ai që bën një gabim, dënohet me gjobë, pastaj do të përmirësohet dhe s'do bëjë më gabim, sepse e ka vuajtur tashmë në planin financiar. Nuk është burgu e vetmja mënyrë, sepse kështu rëndojmë edhe buxhetin e shtetit, edhe mundësitë për t'i administruar, se ne 3 milionë njerëz jemi. me këtë Kod Penal i bie të shkojë në burg gjysma e njerëzve. Të lëmë mundësinë e dënimeve alternative.

Kaq kisha.

Ermonela Felaj – Shqetësimi i zotit Sterkaj ka vend, por duhet ta sqarojmë se si funksionon dhënia e dënimeve alternative.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Po e marr analizën në invers, domethënë nga i fundit, për të arritur tek ju.

E para, sa i takon dënimit me gjobë, neni 34 i Kodit Penal bën specifikimet e mënyrës së deklarimit fajtor dhe dënimeve me gjobë, kështu që e ezauron gjithë çështjen e masave të dënimit me gjobë. E para.

E dyta, sa i takon shqetësimit të zotit Sterkaj.

Në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal, neni 59 e vijues i tij bën analizën dhe identifikimin e alternativave të dënimit me burgim, paçka se në këto paragrafe, në këtë dispozitë, thuhet se kjo vepër dënohet nga kaq deri kaq vjet burg. Në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal ka gjetur zgjidhje edhe shqetësimi se në cilat raste gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Epo është në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal, jo në çdo dispozitë në vetvete. Ju lutem të më kuptoni në lidhje me këtë. Është gjykata ajo, që në përputhje me rekordet kriminale të personit nën hetim, nëse ka kryer apo jo vepër penale, ekzistenca e disa

rrethanave lehtësuese, kur nuk është recidivist e të tjera, vendos aplikimin e dënimeve alternative apo të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim.

Kështu, mos e merrni me aq frikë, se për çdo rast apo për çdo vepër penale të kryer do të ketë burg se s'bën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Paulin Sterkaj – Mos na thuaj ne: mos e merrni me frikë, se s'jemi ne përdoruesit e bixhozit e as administruesit e lojërave të fatit, por duhet t'i mendosh gjërat sikur je të jesh edhe ti në këtë pjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sikur të jetë edhe fëmija yt në këtë pjesë. ne jemi në një moshë, kur mund të gjykojmë në bërjen e ligjeve, të cilat realisht duhet të zënë vendin e duhur edhe në opinionin publik, po edhe në jetën e përditshme. Gjithkush ka fëmijë, prandaj duhet të bëjmë ligje që funksionojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Diku luhet bixhozi, diku pengohet bixhozi. Po a ka mundësi të presim pak deri sa t'u mbarojë kontrata atyre që lozin bixhoz, e atëherë të vëmë ligje të ashpra? Sepse, unë e kam problem këtë: diku luhet bixhozi, diku ndalohet bixhozi. Diku jepen licenca për bixhoz, diku dënohen për bixhoz.

Adnor Shameti – Pa diskutim.

Paulin Sterkaj – A kemi mundësi të mundësojmë edhe pasjen e dënimeve alternative? Të mos shkojmë në ekstrem. Unë s'e marr vesh se Çfarë ju ka shtyrë juve të bëni këtë amendament.

Vasilika Hysi – A mund ta sqarojmë pak këtë punën e dënimit alternativ, se vetëm fjala ka krijuar konfuzion. Nuk është se ka një dënim alternativ. Alternativa është në mënyrën e vuajtjes së dënimit. Dënimet janë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më dëgjo deri në fund, se pastaj do të biesh dakord me mua!

Paulin Sterkaj – Mos më jep mësim! Unë kam bindjen time, ndaj po ju them: nuk ka nevojë të më ndërhyini fare. Unë e kam bindje këtë, ndaj kërkoj që të hidhet në votë. Në rast se unë propozoj një...

Ermonela Felaj – Kodi parashikon: kur ka dënime me burg deri në një vit, gjykata mundet që, për shkaqe të ndryshme, ta vendosë ekzekutimin në gjysmë liri.

Paulin Sterkaj – Po pse të mos fillojmë te ato nene në Kodin penal, që janë me gjobë e deri në dy vjet burg?

Ermonela Felaj – Atëherë, alternativat janë në vuajtjen e dënimit. Gjykata është e orientuar. Në qoftë se jep një dënim deri në pesë vjet, fjala vjen, ajo mund ta pezullojë dënimin dhe t'i thotë të dënuarit: ti nuk do të shkosh asnjë ditë në burg, po për 18 muaj ose për një afat që e çmon gjykata, ti nuk do të kryesh asnjë vepër tjetër penale.

Kjo është një alternativë. Alternativë tjetër është...

Paulin Sterkaj – Atëherë po ta them unë: kësaj i thonë t'ia rrisësh autoritetin në mënyrë false gjykatës dhe t'ia lësh vlerësimin gjykatës.

Ermonela Felaj – Por i kemi vënë kushte gjykatës, se kur duhet ta bëjë këtë gjë.

Paulin Sterkaj – A e kemi shqetësim të madh korrupsionin? Reforma në drejtësi për çfarë është bërë? Për këto penetrime që ka bërë gjykata dhe prokurorë të ndryshëm nëpër Shqipëri. Pse nuk duhet t'i fiksojmë në ligj këto gjëra, që ta detyrojmë gjyqtarin, që kur ta shohë nenin...

Ermonela Felaj – Po pra, atë i kemi thënë gjyqtarit. Atë jam duke thënë edhe unë. Ne i kemi thënë gjyqtarit: kur ti je përballë një vepre të tillë, me një dënim të caktuar, ti do të zbatosh alternativën. Pra, nuk do ta çosh në burg, por do t'ia pezullosh ekzekutimin. Ai nuk do të vuajë asnjë ditë burg ose do të jetë në gjysmë liri, që do të thotë se bën një pjesë të dënimit brenda, një pjesë të dënimit jashtë.

Pra, alternativa në vetvete nuk është dënim, sepse dënimi është ose gjobë ose burg. Alternativa është te mënyra se si e vuan ti: e vuan brenda burgut apo e vuan i lirë? Kodi e ka të orientuar këtë pjesë. Kështu është.

Spartak Braho – Alternativa është alternativë dënimi.

Ermonela Felaj – Po pra, por te mënyra e vuajtjes së dënimit.

Paulin Sterkaj – Si me gjobë, si me kusht, si me detyrim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Në rregull! Edhe një koment të fundit dhe e mbyllim këtë pjesë.

Adnor Shameti – Dua të dal te thelbi i dispozitës, i nenit 4, tek çështja që ju ngritët me të drejtë. Ka një problem të teknikës legislative, në mënyrën se si është hartuar. Thelbi është perfekt në qëndrimin tonë, por vërejtjet tuaja në riformulimin dhe rregullimin e teknikës së përdorur qëndrojnë. Atëherë, që paragrafet të ndahen më qartë, që të dalë edhe identifikimi i subjektit përkatës në çdo paragraf. Për dijeni të anëtarëve të Komisionit, të Sigurisë, dua të sqaroj se paragrafi i parë ose fjalia e parë, sepse varianti i paraqitur nuk është ndarë në

paragrafë, por si subjekt i paragrafit të parë janë organizuesit, pra ata që e bëjnë biznesin. Ndërsa paragrafi i fundit apo fjalia e fundit, është për përdoruesit, për ata që luajnë. Subjekti është i përgjithshëm. Kështu që, nuk ka kundërthënie midis paragrafit të parë dhe paragrafit të fundit.

Ermonela Felaj – Jo, kundërthënia qëndronte vetëm te fakti se po ta thuash ushtrimi i veprimtarisë.

Adnor Shameti – Ushtrimi i veprimtarisë. Jam dakord!

Ermonela Felaj – Të shtohet si veprimtari. Të thuash ushtrimi i veprimtarisë së bixhozit apo pjesëmarrja në lojërat e bixhozit, është e njëjta gjë.

Adnor Shameti – Jam dakord!

Ermonela Felaj – Le që nuk shkon si “ushtrimi”, se ajo nuk kërkon mjeshtëri tani.

Adnor Shameti – Pa diskutim, por nuk cenojnë thelbin e draftit të paraqitur. Kështu që, jam shumë dakord që të pasqyrohet në paragrafin e parë. Pra, në paragrafin e parë të identifikohet dhe të dalë e qartë se ata që dënohen janë organizuesit, ata që bëjnë biznesin. Ndërsa në paragrafin e fundit, është ai që luan bixhoz.

Ermonela Felaj – A jeni dakord që, për sens organizimi, dispozita e fundit të dalë e para. Pra, merremi njëherë me pjesëmarrjen, që është më e lehtë. Ka të drejtë zoti Braho, që thotë për pjesën e gjobës.

Adnor Shameti – Është çështje e teknikës legislative, nuk përbën asnjë problem.

Ermonela Felaj – Në fakt, pavarësisht se në teori mësojmë se kundërvajtje janë ato që dënohen deri në dy vjet burg, ka qëndrime të mëvonshme, që thonë se duhet ta parashikojë ligji që është kundërvajtje. Në momentin që ne nuk themi se është kundërvajtje ose është krim, gjoba ndryshon. Pra, ju e dini se për kundërvajtjen do të ishte 500 mijë lekë të vjetra, ndërsa 100 mijë të reja do të ishin për krimin, si gjoba më minimale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po. Ja, të mbaroj!

Atëherë, paragrafi i fundit do të kalojë si paragraf i parë, të bëhen korrigjimet në paragrafët e tjerë, dhe paragrafi i parë të parashikohet si kundërvajtje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Paulin Sterkaj – Me këtë paragraf, shqetësimi i zotit Sterkaj nuk plotësohet në asnjë moment. Pse? Sepse në Shqipëri ke lojëra bixhozi të ligjshme, ndërsa ti dashke të dënosh atë që luan. Në kohën e Enverit, nëse ju kujtohet, vinin edhe bast të tipit: ku ndalon miza, ndalet miza më parë te unë apo te ti, dhe viheshin lekë. Vihej bast për lojëra futbolli etj.

Pra, bastet realizohen në 101 mijë forma, por nëse në ambient është i ligjshëm, ndërsa në një ambient tjetër dënohesh, kjo nuk më duket e drejtë.

Adnor Shameti – Zoti Sterkaj, kjo është e tejkaluar që në momentin kur miratuar ligjin në atë gjuhë që e kemi miratuar.

Ermonela Felaj – Sepse ne e kemi thënë se cilat quhen lojëra fati. Nuk kemi quajtur lojë fat kështu çdo lloj basti. Është te ligji për lojërat e fatit, se cilat quhen lojëra fati. Pra, që të dënosh për pjesëmarrje në lojëra fati, duhet të kesh parasysh atë lojë që parashikon ligji i veçantë, jo çdo gjë që mund të marrim ne me mend. Ligji “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” thotë se lojëra fati janë: një, dy, tre, katër. Kjo është ideja.

Paulin Sterkaj – Unë do të votoj kundër.

Ermonela Felaj – Në rregull!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eljo Hyska – Pjesa më e madhe e lojërave të fatit luhen në mënyrën online. Pra, kompanitë nuk janë të regjistruara në Shqipëri, kështu që lojërat bëhen nëpërmjet telefonit. Kjo do të thotë se subjekt janë vetëm persona, të cilët operojnë në Shqipëri. A marrim dot ne masa kundër kompanive, të cilat faktikisht thyejnë ligjin shqiptar? Ato janë kompani të huaja, që ndryshojnë IP-në, ndryshojnë vendndodhjen e të gjitha me radhë, dhe vazhdojnë të operojnë. Pra, njerëzit i luajnë këto lojëra me celular.

Ermonela Felaj – Po, zoti Shameti, në lidhje me pyetjen e zotit Hysko.

Adnor Shameti – Të gjitha këtyre pyetjeve tuaja u jep përgjigje ligji specifik që kemi kaluar, në lidhje me ndalimin e lojërave të fatit, që e kemi kaluar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë para disa muajsh. Thelbi është: personit që kapet, i duhen gjetur edhe provat, sepse është çështje e provueshmërisë dhe e realizimit të elementëve provues. Nëse personi “A” kapet duke organizuar një veprimtari, e cila për efekt të ligjit që ne kemi miratuar në Kuvend për ndalimin e lojërave të fatit, bien në kundërshtim me ligjin, atëherë organizuesi do të mbajë përgjegjësi. Në të kundërt, nuk ka asnjë lloj përgjegjësie.

Ermonela Felaj – Mirë. Atëherë, me vërejtjet e bëra për nenin 4, kush është dakord? Përveç zotit Sterkaj, i cili e mbajti qëndrimin.

Kush është kundër? 2.

Me shumicë votash, ky nen miratohet, së bashku me vërejtjet e bëra në këtë komision.

Tani kalojmë te një grup nenesh. Neni 5, i cili bën fjalë veprat penale që lidhen me mjedisin. Në fakt, janë disa nene: ndotja e ajrit dhe e tokës, shkaktimi i fatkeqësive

mjedisore, menaxhimi i mbetjeve, transportimi i mbetjeve, aktivitetet e rrezikshme, materialet bërthamore dhe substancat e rrezikshme radioaktive, dëmtimi i specieve të mbetura të florës e të faunës së egër, habitatet në zonat e mbrojtura, si dhe substancat ozonholluese.

Pra, po themi nga neni 5 deri te neni 9, kemi një grup nenesh, të cilat shtohen te kreu i veprave penale që lidhen me mjedisin.

Ia vlen të thuhet dy fjalë: këto vepra futen për herë të parë në Kodin Penal. Është e domosdoshme t'i fusim, sepse në këtë kre Kodi ynë Penal reflekton një realitet krejtësisht të lënë pas me dekada me radhë. Pra, ka 30 vjet, që ne mbajmë në Kodin tonë Penal të njëjtin kuadër ligjor për veprat penale kundër mjedisit, kur dihet e veprimtaria e njeriut në mjedis është rritur në mënyrë të jashtëzakonshme. Bashkë me veprimtarinë e njeriut në mjedis, janë rritur edhe pasojat që i vijnë mjedisit, pasoja të cilat nuk mund të na lënë neve indiferentë, sepse edhe ne jemi pjesë e këtij mjedisi, e sigurisht që pësojmë dëmtime në jetën e në shëndetin tonë, deri në përfundime të rënda e fatale si humbja e jetës.

Kështu, i gjej me vend të gjitha propozimet që janë bërë, por jam munduar t'i shoh në tërësi, duke pasur parasysh e ka edhe një komision, i cili do të jetë më specifik te veprat penale kundër mjedisit, siç është Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, ku ka kolegë që i janë kushtuar kësaj fushe, kjo edhe për shkak të formimit të tyre profesional. Kësisoj, nuk kam dashur të ndërhyj në detaje, por kam një koment në përgjithësi, që si juristë, besoj se na takon ta bëjmë.

Mendoj se mekanizmi i dënimit, që është përdorur në disa nene, është mekanizëm i pazakontë për Kodin tonë Penal. Pra, çfarë është propozuar në disa nene? Të dënohet me gjobë, thuhet, ose me burg, nga një masë minimale dënimi deri në një masë maksimale dënimi. Dua t'ju kujtoj se Gjykata jonë Kushtetuese e ka shpallur antikushtetuese dhënien e dy dënimeve kryesore njëherazi. Pra, të japësh edhe gjobë, edhe burg, se këto janë dënime kryesore, në Shqipëri është diçka antikushtetuese. Për sa kohë që ai vendim i Gjykatës Kushtetues ekziston si i tillë, ne nuk mund të aplikojmë në Kodin tonë Penal dënime që shkojnë bashkë: edhe gjoba, edhe burgu.

Nga ana tjetër, po të shohësh gjithë Kodin Penal, në mbi 300 nenet e tij, ose më pak se kaq, nëse heqim pjesën e përgjithshme, mënyra se si operohet të dënimi, është: ose gjobë, ose burg. brenda dënimit me burgu, ti ke minimalen e dënimit me burgim, dhe maksimalen, që fillon nga pesë ditë deri në 35 vjet ose burgim i përjetshëm.

Kësisoj, do të isha e ideo e kësaj masë së dënimit të mund ta shikonim, pra të linim ose gjobë, ose burg, duke e përcaktuar se sa kohë. Njëkohësisht, të mund të shikojmë pak

edhe marzhin e dënimit, sepse në disa vende konstatoj se hapësirat janë lënë shumë të gjera. Po themi se aty ka dënime që shkojnë nga 5 deri në 15 vjet burg, hapësira është shumë e gjerë, dhe dihet e hapësirat shumë të gjera lënë vend gjithmonë për abuzim ose për korrupsion. Të ngushtohet pak hapësira. Nuk po them t'i përputhim, por gjithsesi, hapësira duhet të jetë pak më e ngushtë.

Kjo është vërejtja që kam në përgjithësi për këtë grup nenesh, nga neni 5 deri te neni 9, të cilët kanë të bëjnë me mjedisin. Me pjesën tjetër, si relatore, do të isha dakord që të qëndronte.

Po, zoti Shameti!

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Në vijim të fjalës suaj dhe argumentit të plotë që ju paraqitët para komisionit, dua të shtoj vetëm diçka, të cilën e kemi shprehur edhe në paraqitjen që kemi bërë para Komisionit të Sigurisë në seancën e miratimit në parim të këtij projektligji, përveçse është diçka e re, që nuk ka gjetur rregullim në Kodin ekzistues Penal, ndryshimet e paraqitura në këtë pjesë të ligjit pasqyrojnë edhe detyrimet ndërkombëtare që Shqipëria ka, pasi janë në funksion edhe të direktivave dhe rezolutave përkatëse (e fundit ka qenë e vitit 2016), të cilat e detyrojnë Republikën e Shqipërisë të bëjë rregullimet përkatëse në Kodin Penal për këtë grup veprash penale, të cilat janë të detyrueshme si pjesë e përafrimit të legjislacionit tonë me atë të Bashkimit European.

Për sa i takon sugjerimit tuaj në përcaktimin e një marzhi të drejtë të masave të dënimit për secilin paragraf, jemi të hapur duke e miratuar këtë variant, por, duke parë kushtet e teknikës legislative dhe harmoninë me dispozita të tjera të ngjashme, të ruhet e njëjta linjë në përcaktimin e masave dhe llojeve të dënimit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shameti!

Besoj se nuk ka ndonjë qëndrim tjetër në raport me këtë gjë.

Kush është dakord me diskutimin që patëm në përgjithësi për nenet 5, 6, 7, 8 dhe 9?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Atëherë, biem të gjithë dakord sipas diskutimit që u bë për të riparë vetëm mekanizmin e sanksionit.

Kalojmë në nenin 10 të projektligjit, i cili, në fakt, reflekton nismën e shoqatave për mbrojtjen e kafshëve dhe jo vetëm. Mendoj se këtë gjë kanë pasur parasysh propozuesit në propozimin e këtij neni.

Çfarë propozohet t'i shtohet Kodit Penal? Propozohet t'i shtohet një nen me titullin “Shkelja e rregullave të mbajtjes së kafshës së shoqërimit” që, po ta shohësh në përmbajtje, synon të mbrojë personat nga përdorimi ose nga mbajtja e kafshëve jo në mënyrë adekuate.

Unë kam vetëm një sugjerim të vogël.

(Deputeti Shameti ndërhyr pa mikrofon.)

Vetëm një sekondë, ju lutem, te ky aspekt!

Ne mund ta mbyllim edhe te dhjetë nenet e para, për të vazhduar me pjesën tjetër të neneve në një mbledhje tjetër, sepse, në fakt, është goxha ngarkesë.

Atëherë, propozohet formulimi: “Mosvendosja e maskës së qenve agresivë”, por i thënë kështu, më duket shumë subjektiv. Mendoj se duhet të ishte shprehur ndryshe, për shembull: “mbajtja e maskave për kafshët (qen) e racave, që dihen se janë realisht të rrezikshme për njeriun, të jetë e detyrueshme”, por duke e specifikuar për cilën racë, jo ta lëmë kështu në përgjithësi, në mënyrë që të mos t'i vendosin maskë një qeni, që nuk është i rrezikshëm.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Unë futem tek ata deputetë, të cilët e kanë parë si të parakohshëm propozimin e ardhur nga shoqëria civile për të reflektuar dispozitat për mbrojtjen e kafshëve, por duke e parë tani, besoj se duhet një ndërrhyrje në këtë pikë nga ana juaj në Komisionin e Ligjeve.

Megjithatë, këtu ka kolegë që kanë mbajtur qëndrim pro atij ligji dhe besoj se do të na ndihmojnë me ndërrhyrjet e tyre.

Adnor Shameti – Mund ta sqaroj?

Ermonela Felaj – Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të bëj një parantezë këtu. Varianti i paraqitur në nenin 10 është i pjesshëm dhe nuk reflekton pjesën e nismës legislative të 35 mijë shtetasve, të sjellë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet disa NGO-ve (shoqatave për mbrojtjen e kafshëve). Kjo ka qenë nisma kryesore që ka ardhur në Kuvendin e Shqipërisë.

Si relator i asaj nisme, i atij propozimi, dua të them që ne kemi avancuar. Pra, nga ana e një grupi shtetasish dhe nga ana e këtyre përfaqësuesve të disa shoqatave për mbrojtjen e të drejtave të kafshëve ka ardhur propozimi vetëm për njërin anë të medaljes: mbrojtjen e kafshëve nga keqtrajtimi. Ndërkohë, në grupin e punës kemi avancuar, madje e kemi çuar për miratim në Komisionin e Ligjeve, duke parë të dyja anët e medaljes, sepse, nga njëra anë, kemi mbrojtjen e kafshëve nga njerëzit dhe, nga ana tjetër, kemi mbrojtjen e njerëzve nga

kafshët e rrezikshme, pasi një kafshë e rrezikshme mund të përdoret si pushkë për të vrarë një njeri dhe nuk mund të trajtohet thjesht si një kundërvajtje administrative ose penale.

Në këtë kuptim, do t'i sugjeroja Komisionit për Sigurinë Kombëtare që ta kalojmë variantin siç është në, por ju siguroj që në variantin përfundimtar do të kemi një draft të integruar, që në grupin tonë të punës e kemi përmirësuar dukshëm, me asistencën shumë të rëndësishme të misionit EURALIUS këtu. Ju siguroj që në variantin përfundimtar do të kemi një draft të integruar të të dyja nismave: nga njëra anë, të grupimit të shtetasve dhe shoqatave për mbrojtjen e kafshëve dhe, nga ana tjetër, variantit të propozuar nga një grup deputetësh. Ndaj, ju ftoj që ta kalojmë si të tillë. E përsëris, ju siguroj që në Komisionin e Ligjeve do të kemi draftin e integruar të këtyre dy nismave.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shameti, për komentin tuaj!

Megjithatë, kolegët duan të ndërhyjnë, veçanërisht për paragrafin që parashikon se mosvendosja e maskës mbrojtëse për qentë agresivë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 30 mijë deri 100 mijë lekë të rinj.

Fjalën e ka zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea Hoxha – Faleminderit, zonja Felaj!

Ndoshta kam një ndjeshmëri të lartë për këtë çështje, sepse kam një qen, por dua, në fakt, të bëj disa pyetje.

E para, cili konsiderohet qen agresiv?

E dyta, thoni këtu: “Nxitja me qëllim egërsimin e kafshëve që paraqesin rrezik për njerëzit”. A mund ta sqaroni pak më shumë këtë paragraf?

Faleminderit!

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Ermonela Felaj – E shihni që mbizotërojnë dy ndjeshmëri: ata që janë pro dhe ata që janë kundër?

Adnor Shameti – Jam shumë dakord, ndaj e bëra edhe parantezën. Madje ju siguroj, zonja Gjebrea, që për variantin e integruar, që do të kalojmë në Komisionin e Ligjeve, kemi pasur ekspertizën më të mirë ndërkombëtare nga misioni EURALIUS. Për më tepër, në gjuhën që e kemi paraqitur, e kemi shtrirë në dy dispozita, ku, nga njëra anë, e përsëris, është e përpunuar me përvojën më të mirë të vendeve të Bashkimit Europian dhe, nga ana tjetër, ju siguroj që të gjitha shqetësimet tuaja do të gjejnë pasqyrim dhe do të jenë të reflektuara në variantin përfundimtar që do t'ju paraqitet.

Në këto kushte, do t'ju lutesha vetëm të prisnit dhe të shikonit variantin e integruar që do të kalojmë në Komisionin e Ligjeve.

Elona Gjebrea Hoxha – Faleminderit, zoti Shameti, por nuk iu përgjigjët pyetjes sime!

(Diskutime në sallë)

Adnor Shameti – Edhe terminologjia dhe të gjitha elementet e tjera, që ju shqetësojnë, do të gjejnë pasqyrim, prandaj edhe vërejtjet e zonjës do të bëhen pjesë e integruar e relacionit, që Komisioni për Sigurinë Kombëtare do t'ia kalojë Komisionit të Ligjeve.

Ermonela Felaj – Po, zoti Sterkaj.

Paulin Sterkaj – Paulin Preka dhe Tano Banushi kanë pasur një numër estrade në Shkodër, ku njëri i thoshte tjetrit: “Kaloje murin, se qeni që leh, nuk të ha”. Por nuk e di nëse qeni e njeh proverbin.

(Diskutime në sallë)

Në këto kushte, qeni e njeh Kodin Penal, apo jo, se këtë nuk po kuptoj tani?!

(Diskutime në sallë)

Ju keni parashikuar masa vetëm për njerëzit. Po për qentë a ka masa? Duhet parashikuar masa edhe për qentë, se, madje, në Europë dhe në të gjithë globin, ka burgje edhe për qentë, ka raste edhe kur qentë i marrin nga familja, se nuk mund t'i ekzekutojnë (nuk i lejon ligji për të drejtat e kafshëve). Ndaj shtroj pyetjen: si do të veprohet me qentë agresivë? A ka ose jo kosto kjo punë? Sepse për ta bërë ligjin të kompletuar, duhet të ketë edhe një vend-grumbullimi për këta qen agresivë. Unë e kam rritur qenin dhe nuk më bën dora. Është bërë agresiv, nuk e njeh Kodin Penal dhe e ka ndarë mendjen të hajë njerëz. E kupton? Tani, unë dua ta çoj diku, sepse nuk mund ta vras. Çfarë masash do të merren në raste të tilla?

(Diskutime në sallë)

Çfarë mënyrash njihen në legjislacionin shqiptar, pa cenuar të drejtat e kafshëve?

Ermonela Felaj – Detyrimet, në fakt, ashtu siç propozohen, janë për mbajtësit e kafshëve. Pra, ata duhet të kujdesen, në çdo rast, që t'i mbajnë dhe t'i trajtojnë në mënyrën që parashikon ligji “Për mbrojtjen e kafshëve”.

Për sa u përket kafshëve të rrugës, besoj se e kanë detyrim autoritetet lokale, të cilat, gjithashtu, sipas nenit që propozohet, kanë përgjegjësi.

Qëllimin ose komentin ne e kishim për pjesën: kush do të konsiderohet qen agresiv dhe për cilët prej qenve do të jetë mbajtja e detyrueshme e maskës.

Megjithatë, zoti Shameti, unë nuk mendoj që duhet ta themi këtë gjë Kodi Penal. Ndoshta reflektime më të hollësishme për këtë dispozitë të bëhen në ligjin “Për mbrojtjen e kafshëve”. Ky nen të jetë i natyrës sa më të përgjithshme dhe të dënojë ato fenomene, që, realisht, na kanë shqetësuar të gjithëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është edhe aq e thjeshtë, sepse të provosh të dalësh, bie fjala, nga Liqeni pasdite, është një torturë e vërtetë, për shkak të njerëzve që mbajnë qen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka edhe nga ato specie që duken realisht të rrezikshme për njerëzit. Prandaj, ta disiplinosh këtë pjesë do të ishte vërtet gjëja e duhur; do t’ia vlente.

Atëherë, biem dakord me të gjitha komentet e bëra për nenin 10 të projektligjit?

(Të pranishmit shprehen dakord)

Faleminderit!

Miratohet neni 10, me vërejtjet e bëra në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, por ata nuk janë kundër në parim, se e kanë votuar në parim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdojmë edhe pak me pjesën e goditjes për shkak të detyrës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se kemi edhe pak kohë. E vazhdojmë mbledhjen deri në orën 12:00?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, janë bërë disa propozime për veprat penale, që kanë të bëjnë me goditjen për shkak të detyrës, që, në fakt, kanë të bëjnë edhe me qëndrimin që kemi mbajtur në publik si maxhorancë. Pra, për shkak të shtimit në mënyrë të jashtëzakonshme të rasteve të goditjes ndaj personave publikë, të zgjedhur ose jo (gjithnjë rastet e goditjes së tyre kanë qenë të lidhura me detyrën e tyre), kemi ndeshur problematikën që dënimi i parashikuar në Kodin Penal ekzistues nuk është i mjaftueshëm për të parandaluar ndodhjen e akteve të tilla.

Kështu që nga propozuesit është reflektuar në këtë pikë, duke ndërhyrë qoftë te masa e dënimit për veprën penale “goditja për shkak të detyrës”, qoftë edhe duke e cilësuar subjektin. Pra, goditja për shkak të detyrës ka pasur, le të themi, subjekt të posaçëm, por të përkufizuar në mënyrë të përgjithshme, por edhe e ka ende, siç është i propozuar, punonjësit që ushtrojnë një detyrë shtetërore ose punojnë në shërbimin publik. Ndërkohë, propozuesit kanë ndërhyrë te kjo dispozitë dhe është thënë: kur vepra e goditjes për shkak të detyrës

ndodh ndaj të zgjedhurve ose funksionarëve publikë (policëve ose mjekëve), dënimi të shtohet. Pra, ndërhyrja në dispozitë ka marrë shkas nga një situatë e rënduar, le të themi, në terren.

Tani, unë kam disa vërejtje për këtë nen, madje dua të tërheq vëmendjen e propozuesit ose përfaqësuesve të propozuesit në komision.

Në dispozitën e propozuar është përdorur shprehja “funksionarë publikë dhe persona në shërbim publik”. Po të shikojmë Kodin Penal, në kreun e krimeve kundër autoritetit të shtetit, në sanksionin që ka të bëjë me veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit përdoret shprehja: “punonjës që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik”, pastaj në veprën penale të korrupsionit flitet për persona që ushtrojnë funksione publike, që i përfshin ata që punojnë në shërbimin publik, si dhe për funksionarët e lartë shtetërorë. Pra, unë mendoj që ne të jemi të kujdesshëm në ndërtimin e kësaj dispozite ose në ndërhyrjen te kjo dispozitë, duke i renditur në mënyrën e duhur figurat, të cilave duam t’u japim mbrojtje të veçantë, por që nuk e kanë. Pra, duke thënë, për shembull, për të zgjedhurit: Nuk kemi një mbrojtje të veçantë për të zgjedhurit te kjo vepër, ndërkohë kur thua: “funksionarë të lartë shtetërorë” (sepse funksionarët shtetërorë i kanë punonjësit publikë të mbrojtur) të përmenden, gjithashtu, mjekët.

Për sa i përket goditjes ndaj punonjësve të policisë, zoti Shameti, unë nuk do të isha që ndërhyrjen ta reflektonim te neni 237, sepse ky nen ka qenë i ndarë nga nenet 235 dhe 236, që kanë për subjekt punonjësit e policisë, por do të isha që për punonjësit e policisë ndërhyrja të bëhet te neni 236 i Kodit Penal, i cili titullohet “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, ku të ndryshojë që në titull dhe të bëhet “Kundërshtimi i punonjësit të policisë”, sepse nuk mund të vihen në një situatë të tillë vetëm punonjësit e policisë së rendit publik, por mund të jenë edhe ata të Policisë Kriminale, edhe ata të Policisë së Qarkullimit Rrugor e të tjerë. Pra, le të përdorim termin e përgjithshëm “punonjës policie”, se nuk e kemi term abstrakt, por e kemi të përkufizuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit”, duke u dhënë kështu mbrojtje të veçantë të gjithë punonjësve të policisë.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Pra, të reflektojmë ndërhyrjet te neni 236, ndërsa te neni 237 të bëjmë vetëm kujdes, sepse në paragrafin e parë themi: “të dënohen për shkaqe të goditjes të gjithë ata që godasin funksionarë publikë dhe ata që punojnë në shërbim publik ose punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore.

Kë duam të veçojmë duke i dënuar me shumë agresorët? Duam të veçojmë të zgjedhurit, funksionarët e lartë shtetërorë dhe mjekët? Për mjekët vlen diskutimi që bëmë për profesionistin shëndetësor. Nëse nuk e gjejmë të përkufizuar “profesionistin shëndetësor”, të përdorim shprehjen që ka Kodi aktualisht, “personeli mjekësor”? Në qoftë se e gjejmë të përkufizuar nuk kemi probleme. Pra, këto janë vërejtjet që unë kam për këtë pjesë.

Meqenëse pak më poshtë, te neni 12, do të kemi edhe kanosjen për shkak të detyrës, komenti është i njëjtë. Pra, të mos ngatërrojmë “punonjës shtetëror në shërbim publik” me “funksionar publik”, sepse “funksionar publik” e përfshin kategorinë shtetërore në shërbim publik. Mund të jetë deri diku pak më e gjerë, por e përfshin. Mua më duket i njëjti rreth personash. Ndërsa, cilët quhen “funksionarë të lartë publik” është e përkufizuar në ligj të veçantë.

Fjalën e ka zoti Shameti dhe pastaj zoti Hyskaj për një pyetje.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Si profesionist i të drejtës dhe si propozues, të gjitha gjetjet tuaja i shikoj me vend. Logjika e asaj që propozohet është e drejtë, prandaj inkorporimin në dispozita në mënyrën e duhur, që ju me të drejtë e ngrini këtu dhe që duhet t’i bashkëngjitet relacionit të Komisionit të Sigurisë, e shikoj me vend. Jemi të hapur të çojmë në dispozitat përkatëse çdo paragraf, bashkë me sugjerimin për punonjës të policisë. Të gjitha gjetjet tuaja i shikoj me vend, prandaj duhet t’ia dërgojmë të tilla Komisionit të Ligjeve.

Faleminderit!

Eljo Hyska - Si është parashikuar kur një funksionar i lartë, drejtues ose përfaqësues, godet një punonjës, në rastin konkret të policisë? Pra, a ka masa më të ashpra? Pra, në rast se një grup deputetësh të caktuar godasin brenda komisarariatit të policisë një polic apo funksionar të shtetit, a është parashikuar masa e dënimit?

Konkretisht, në internet po qarkullon një video ku duket që brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë një grup ish-deputetësh të Partisë Demokratike godasin dy policë. Nëse keni informacion, në çfarë faze është hetimi ndaj këtij grupi? A është parashikuar një masë më e ashpër që kjo të parandalohet, sepse ne po parashikojmë goditjen ndaj funksionarëve të Policisë së Shtetit nga qytetarët e thjeshtë, ndërkohë nuk po marrim masa ndaj atyre, të cilët kanë qenë funksionarë?

Ermonela Felaj – Zoti Shameti, mbani ju një qëndrim për pyetjen e zotit Hyska, meqenëse jeni relator.

Adnor Shameti – Subjekt i posaçëm është marrëdhënia shoqërore që mbrohet. Kështu që, subjekti i posaçëm është punonjësi i policisë. Cilido të jetë ai që e dhunon punonjësin e policisë, si subjekt i posaçëm, i mbrojtur nga kjo dispozitë, që do të ndryshohet, dënohet.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Pra, nuk ka diferencë. Kushdo që do ta kryejë, nuk ka diferencë. Diferenca bëhet tek ai që merr goditjen. Pra, ka subjekte që i mbrojmë më shumë se të tjerat, si, policët, të zgjedhurit, funksionarët, punonjësit që kryejnë një detyrë shtetërore, por vetëm kur vepra ndaj tyre lidhet me shkaqe të detyrës. T’i mund të vjedhësh një person të thjeshtë ose një person që ka një detyrë shtetërore, por kjo nuk do të përbëjë dallim në dënimin e vjedhësit.

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Unë do ta shtroj edhe njëherë problemin parimisht.

Në 5-6 rastet që parashikon neni 11 prevalon dënimi me burgim, që fillon nga 1-3 vjet, 1-5 vjet, apo 5 vjet. Të gjitha dispozitat parashikojnë për këto vepra penale 5 vjet burg.

Unë gjykoj që, duke shtuar dënimin me gjobë, ne nuk e lehtësojmë dispozitën, përkundrazi, e shtrëngojmë atë. Ama, vënia e gjobës, padyshim, si lloj dënimi dhe mënyrë e vuajtjes së dënimit, na krijon një hapësirë mospenalizimi deri në masën sa tjetri, për një sherr që ata mund të merren vesh më vonë, të vuajë dënimin me burg.

Pse thotë Kryeministri “të gjithë në burg”, në të gjitha dispozitat vendoset burgu! Nuk shkon kështu. Duhet të vendosim gjobën.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Braho!

Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Qëllimi ynë si grup propozues për këtë dispozitë për mbrojtjen e kësaj marrëdhënieje shoqërore të këtij grupi subjektesh të posaçme është i qartë. Ata që dhunojnë apo guxojnë të dhunojnë këtë grup subjektesh të posaçme duhet të shkojnë në burg, sepse gjobat na kthehen si gjobat për mosrespektim të kuotave gjinore dhe kryetari i partisë, që fut një kundërvajtës apo kriminel ndaj këtij grupi subjektesh të posaçme, nuk e ka problem të paguajë edhe lekët e gjobës. Ai dhe kushdo që e shtyn atë për të cenuar këtë marrëdhënie shoqërore të posaçme duhet të shkojë në burg.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Ka koment tjetër nga kolegët?

Kush është dakord që vërejtja që bëmë për veprën penale të goditjes për shkak të detyrës, që është njëkohësisht edhe neni 11 i projektit, të reflektohet nga Komisioni i Ligjeve në mënyrën si u diskutua? Kundër dhe abstenime nuk ka.

Miratohet.

Në të njëjtën logjikë ne diskutuam edhe nenin 12, kanosjen për shkak të detyrës. Renditja e subjekteve duhet të bëhet më me kujdes. Kush është dakord me nenin 12, me vërejtjet e bëra?

Faleminderit!

Miratohet!

Neni 13 i referohet pengimit të ushtrimit të detyrës të profesionistit shëndetësor. Për të mos rënë në përsëritje, edhe këtu kemi vetëm diskutimin e termit “profesionist shëndetësor”

Vërejtja e dytë është se është parashikuar vetëm dënimi me gjobë. Dhënia e dënimeve fikse është antikushtetuese. Kështu që, duhen parë të dyja këto momente. Kemi ndonjë ndërhyrje tjetër nga kolegët?

Miratohet neni13.

Neni 14.

Në nenin 14 të projektit është bërë një ndërhyrje në nenin 274 të Kodit Penal, “Prishja e qetësisë publike”. Është propozuar të shtohet një paragraf: “Ushtrimi i veprimtarisë ekonomike, që lëshon, gjeneron zhurmë në mjedis, në kundërshtim me ligjin apo në tejkalim të normave të lejuara me ligj, kur është marrë më parë masa administrative, dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 1 000 000 lekë ose me burgim deri në 2 vjet”.

Komentet që unë kam për këtë paragraf, që propozohet t’i shtohet nenit 274 janë:

Së pari, për sa i përket formulimit, natyrisht që veprimtari të ndryshme ekonomike gjenerojmë zhurmë, por nuk duhet të dënohen për këtë fakt. Duhet të dënohen në rastet kur zhurma gjenerohet në zona të banuara dhe kur ajo kalon limitet e përcaktuara me ligj.

Gjithashtu, mendoj se nuk duhet dënuar vetëm ushtrimi i këtyre veprimtarive ekonomike që shkaktojnë zhurmë në mjedise të banuara nga njerëzit, por, mbi të gjitha, pjesë e dispozitës duhet të bëhen edhe lokalet. Unë di që spuntoja për këtë gjë grupit propozues i ka ardhur nga zhurmat që krijojnë lokalet në zona apo lagje të ndryshme. Pamundësia për t’i disiplinuar ato me masat aktuale ka çuar në propozimin e një paragrafi të tillë në nenin e

Kodit Penal që parashikon prishjen e qetësisë publike. Mendoj ta riformulojmë dispozitën duke përcaktuar zhurmat që krijohen përtej limitit në ambiente të banuara.

Së dyti, të shtohen lokalet.

Së treti, të shikohet mekanizmi i dënimit, që ne e diskutuam edhe njëherë, që përdor dy lloje dënimi, minimale dhe maksimale, me gjobë dhe burgim. Duhet të përdorim ose njërën ose tjetrën, jo të dyja njëherazi.

Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Në vijim të argumentit tuaj, sugjeroj të shtohet “ushtrimi i veprimtarisë ekonomike në një mjedis publik”. Kjo e zgjidh atë.

E dyta, bazueshmëria apo jo në ligj e kësaj veprimtarie ekonomike dhe e zhurmave të gjeneruara prej këtij biznesi. Nuk ka nevojë ta specifikojmë nëse është pub, gurore apo furrë buke, rëndësi ka që është ezauruar pjesa administrative, ka shkuar inspektorati i mjedisit, e ka parë, janë tejkaluar nivelet e zhurmës të ligjit specifik për veprimtarinë e atij institucioni, ka marrë gjobën administrative. Nëse është në përsëritje, atëherë përbën vepër penale.

Për sa i takon logjikës suaj, që duhet parë marzhi i dënimit, jam shumë dakord që të jetë e njëjta logjikë që përdoret edhe në dispozitat e tjera të Kodit Penal.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Kjo dispozitë të jep përshtypjen që nuk është formuluar nga i njëjti grup pune që ka punuar me këto propozime, sepse këtu parashikohet, pasi është marrë masa administrative, edhe marzhi. Kush mbrohet këtu, që vendoset gjoba dhe nuk lihet vetëm dënimi me burg?

Ata që relatojnë të tilla gjëra, ose bëjnë lobing, ose nuk janë koherent me argumentet që dhanë deri tani. Jam plotësisht dakord me dispozitën që të prevalojë gjoba, ashtu sikundër edhe dënimi me burg 2 apo 3 vjet.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Braho!

Ka diskutim tjetër nga kolegët për këtë nen? Zoti Harusha, zoti Sterkaj?

Kush është dakord me nenin 14, të ridiskutuar? Kundër dhe abstenime nuk ka.

Për shkak të kohës, kërkoj të jemi sa më efektivë në pjesën tjetër të diskutimit. Janë propozuar 23 nene në Kodin Penal. Deri tani kemi kaluar më shumë se gjysmën e tyre. Kemi shkuar deri te neni 14.

Ju lutem kolegëve ta ndërpresim këtu diskutimin për të riparë në një mbledhje tjetër pjesën e mbetur të neneve të propozuara në Kodin Penal.

Ndërkohë, ju njoftoj që nesër Komisioni i Sigurisë do të zhvillojë një vizitë pune në mjediset e drejtorisë së policisë të qarkut Vlorë. Besoj se për agjendën atje jemi të njohur nga vizitat e mëparshme. Është koha t'i mbyllim vizitat në drejtoritë e policisë së qarqeve, siç kemi rënë dakord, me qëllim që raportin tonë mbi konstatimet në këto vizita të mund t'ia paraqesim ministrit të Brendshëm dhe kabinetit të Kryeministrit.

Faleminderit, kolegë!

Faleminderit, zoti Shameti, për angazhimin tuaj!

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA